
Bulqize me date 14/11/2022

PROCESVERBAL
Tipi i kontratës-PUNË

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT:

“NDERTIM I TREGUT BUJQESOR DHE BLEGTORIAL NE LAGJEN MINATORI BULQIZE”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Kodi CPV: 45000000:Pune ndertimi.

VLERA E FONDIT LIMIT:23 751 991(Njzet e tremilion e shtateqind e pesedhjetë e njemije e nenteqind e nentedhjetenjë) lekë pa tvsh, vënë në dispozicion nga Ardhurat, për tenderin me

Objekt: “NDERTIM I TREGUT BUJQESOR DHE BLEGTORIAL NE LAGJEN MINATORI BULQIZE”.

Burimi i financimit: ARDHURAT si më poshtë:

Për vitin 2022 vlera: 23751 991leke pa tvsh.

Argumentimi: Përlllogaritja e vlerës limit të kontratës është referuar në preventivin e përlllogaritur mbështetur në Vendimin nr.629, datë 15.07.2015, “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” të Këshillit të Ministrave.

Afati i realizimit të punimeve është 40 dite (bazuar te grafiku i punimeve)

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, autoriteti kontraktor Bashkia Bulqize (Njësia e Prokurimit), ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8,

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Sipas përcaktimeve në Kriteret e Përgjithshme të Perzgjedhjes /Kualifikimit pika 1 e shtojcës 7.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”si dhe nenit

(Shënim: përcaktoni **nëse është rasti**, aktin konkret ligjor ose nënligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale që lidhet me objektin e prokurimit apo nevojën që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë, kur një gjë e tillë është e detyrueshme nga legjislacioni përkatës).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1.Kopje të certifikuara të bilanceve të tre viteve të fundit 2019, 2020, 2021 të konfirmuara me vule pranë administratës tatimore. Operatorët Ekonomikë të cilët plotësojnë 2 nga 3 kërkesat e gërmes “c” të nenit 41 të Ligjit Nr.10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” të ndryshuar; krahas bilanceve të paraqesin dhe raportet e audituesit të pavarur për bilancet e këtyre viteve të konfirmuara nga administrata tatimore.

Kjo kërkesë për kualifikim, konsiderohet e përmbushur nëse në 2 (dy) bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr. 9920, date 19.05.2008 ”Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nenligjore në zbatim të tij.

Kërkesa për paraqitjen e bilanceve është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, në funksion të realizimit të kontratës.

2.2.2 Kopje të deklaratave të xhiros mesatare vjetore, të realizuar nga Operatori Ekonomik ofertues gjatë 3 (tre) viteve të fundit (2019, 2020, 2021) lëshuar nga Administrata Tatimore, me vlerë jo më të vogël se vlera e fondit limit të kontratës që prokurohet.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare do të konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën njëvittëperiudhë të kërkuar nga autoriteti/entiteti kontraktor.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e xhiros është vendosur që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin 9920 date 19.05.2008, Per Procedurat Tatimore ,neni 64 Deklarata Tatimore.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entitet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

2.2.3 Operatori Ekonomik duhet të paraqese vertetim nga organet e pushtetit lokal (Bashkia) për shlyerjen e taksave vendore për vitin 2022, (për NIPT-in kryesor dhe për NIPT-et sekondare), ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar; ne të gjitha vendet ku ushtron aktivitetin sipas Rregjistrimit në Qendren Kombëtare të Biznesit. Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Bashkia në të cilën është regjistruar sipas QKB-se.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit të BOE, duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Njësitë Administrative përkatëse ku ka ushtruar apo ushtron aktivitet për vitin 2021 dhe detyrimet e maturuara për vitin 2022, sipas të dhënave të QKB-së.

Argumentimi: Kjo kërkesë është bërë në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, sipas të cilit, operatorët ekonomikë duhet të shlyejnë detrimet e taksave dhe tarifave vendore, në çdo adresë ku ushtrjnë aktivitet.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Përvojë të suksesshme në realizimin e të paktën:

- a. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet (pa TVSH) dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Ose

- b. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku e realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet (pa TVSH).

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e ben oferten të kualifikueshme.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit/ve Ekonomike do të kryhet bazuar në dokumentacionin e mëposhtem:

Ne rast se punimet janë kryer me ente publike:

Operatori Ekonomik, si dëshmi për përvojën e mëparshme të realizuar me ente publike, duhet të paraqese formular vlerësimi lëshuar nga Investitori sipas Shtojcës 9 dhe situacioni përfundimtar për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, faktin nëse kontrata është realizuar me sukses, përqindjen e punimeve në rast bashkimi të shoqërive, etj.

Ne rast se punimet janë kryer me sektorin privat:

Operatori Ekonomik, si deshmi te përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet te paraqese vertetime te shoqeruara me faturat tatimore të shitjes, ku te shënohen datat, shumat, natyra e punes se kryer dhe situacion perfundimtar për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

Pika 2.3.1 gërma “a” plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.

Kurse pika 2.3.1 gërma “b” duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. (Neni 88, pika 3, i VKM-se nr.285 date 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave te prokurimit publik” te ndryshuar).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet (pa TVSH) dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. **Ose** punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku e realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet (pa TVSH).

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Referuar fondit limit, sipas nenin 39, pika 5 ”Kërkesa të vecanta për kontratat për punë publike”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

Aftësitë teknike dhe profesionale te tjera si me poshtë janë hartuar, vendosur dhe perlllogaritur nga struktura të posacme të specializuara, mbështetur në Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”:

Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastruktures dhe Energjise, ne baze te VKM nr. 42 datë 16.01.2008, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disilinit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, të ndryshuar, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme :

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit:

2.3.2 Licensa profesionale lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës

a) Operatori Ekonomik duhet të dëshmojë se disponon liçensë profesionale për zbatim punimesh në ndertim, duke përfshirë kategoritë e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesë liçensën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.42 datë 16.01.2008 “Për Miratimin e Rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së liçensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve Juridike që ushtrojnë veprimtari ndertimi”, i ndryshuar.

Operatori Ekonomik duhet të disponojë Liçencë profesionale të shoqërisë, të vlefshme, për kategoritë e mëposhtme:

- **Kategoria NP- 1** Punime germimi në tokë **Klasifikimi A**
- **Kategoria NP- 2** Ndërtime civile dhe industriale **Klasifikimi B**
- **Kategoria NP- 3** Rikonstrukcion dhe mirembajtje godinash, veshje fasada **Klasifikimi A**
- **Kategoria NP- 4** Rruge, autostrada etj. **Klasifikimi A**

- **Kategoria NS-1** Punime për prishjen e ndërtimeve **Klasifikimi A**
- **Kategoria NS-4** Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, **Klasifikimi A**
- **Kategoria NS-5** Impiante të sinjalistikës ndriçuese të trafikut **Klasifikimi A**
- **Kategoria NS-8** Ndërtime parafabrikat beton arme, struktura **Klasifikimi A**
- **Kategoria NS-9** Punime strukturore speciale **Klasifikimi A**
- **Kategoria NS-18** Punime topogjeodezike **Klasifikimi A**

Në rastet e mbështetjes në kapacitete të subjekteve të tjera / Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë, secili anëtar i bashkimit duhet t’i disponojë në raport me zërat, përqindjen e marrë përsipër, sipas angazhimit me shkrim / kontratën e bashkëpunimit.

Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i liçencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Institucionit përkatës, në plotësim të liçencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendim nr.42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores, për kriteret dhe procedurat e dhënies së liçencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndertimi”, i ndryshuar.

Konkretisht:

Llojet e licencave dhe klasifikimi i tyre, sipas kategorive dhe niveleve (gërmave) përkatëse janë bërë në përputhje me natyrën e punimeve respektive dhe vlerën e përlogaritur për secilën natyrë pune, sipas preventivit të hartuar për këtë objekt. Konkretisht:

SipasVKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, kategoria **N.P - 1A** “Punime gërmimi në tokë”: *Konsiderohen gërmimet, sistemimet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjete, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gërmohet ose sistemohet vegjetale, argjilore, ranore, zhavorrishte ose shkëmbore.*

Kjo kategori licence i referohet punimeve të parashikuara në preventiv,

SipasVKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, kategoria **NP-2B** “Ndertime civile e industriale”: *SipasVKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, kategoria NP-2 B “Ndërtime civile dhe industriale”: Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje të sakta në objekte ku zhvillohen aktivitete njerëzore të drejtpërdrejta ose jo, kompletimi me strukturat e nevojshme dhe finitura të llojeve të ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje.*

Kjo kategori licence përfshin natyrën e punimeve objekt kontrate dhe i referohet zërave të parashikuara në preventivin e punimeve të këtij objekti per shtesen e katit, sipas parashikimit të VKM nr. 42 të sipërcituar, për këtë kategori.

SipasVKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, kategoria **NP-3A** “Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasadash”: *Konsiderohen zgjidhjet dhe koordinimi i punimeve të specialiteteve të nevojshme përriaftësim, konservim, konsolidim, transformim, rivlerësim, ristrukturim. Konsiderohen gjithashtudhe finitura të llojeve të ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje.*

Kjo kategori licence përfshin natyrën e punimeve objekt kontrate dhe i referohet zërave të parashikuara në preventivin e punimeve të këtij objekti pjeses qe dote rikonstruktohet, pasi në tërësi kemi të bëjme me rikonstruksion të një objekti ekzistuese, sipas parashikimit të VKM nr. 42 të sipërcituar, për këtë kategori.

SipasVKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, kategoria **NS-1A** “Punime për prishjen e ndërtimeve”: *Konsiderohet çmontimi i impianteve industriale dhe prishja komplet e ndërtesave me pajisjespeciale ose me përdorim eksplozivi me prerje të strukturave betonarmeje dhe prishjeve nëpërgjithësi përfshi edhe grumbullmin e mbeturinave, ndarjen e tyre dhe riciklimin e materialeve.*

Kjo kategori licence i referohet punimeve të parashikuara në preventiv,

SipasVKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, kategoria **NS-4A** “Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastike, metalike dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese”. *Konsiderohet ndërtimi, mirëmbajtje ose ristrukturim i muraturës dhe mureve ndarës të çfarëdo lloji, tipi, përfshirë suvatimin, patinimin, bojatisjen dhe punime të ngjashme me to.*

Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i karpenterisë dhe punimeve prej druri, të dyerve dhe dritareve të brendshme dhe të jashtme, të veshjeve të brendshme dhe të jashtme të dyshemeve të tipeve të ndryshme dhe me materiale të ndryshme dhe të punimeve të realizuara me dorë, me metal, dru, material plastik dhe material xhami ose të ngjashëm.

Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i izolimit termik dhe akustik, nënçatitë dhe mbrojtja nga zjarri, izolimi i natyrave të ndryshme dhe me materiale të ndryshme.

Kjo kategori licence i referohet punimeve të parashikuara në preventiv,

SipasVKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, kategoria **NS-8A** “Ndërtime parafabrikat me beton të armuar, struktura metalike dhe druri”.Përfshin prodhimin në rrugë industriale dhe montimin në vepër të strukturave parafabrikate prej betoni të armuar, normal dhe të paranderur. Prodhimin në kantjer dhe montimin në vepër të strukturave prej çeliku ose të fasadave të përbëra nga telajo metalike dhe elementë modularë prej xhami ose materiali tjetër.

Prodhimin në rrugë industriale dhe montimin në vend të strukturave të përbëra nga elementë të drejtë të trajtuar përpara..

Kjo kategori licence i referohet punimeve të parashikuara në preventiv,

SipasVKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, kategoria **NS-9A** “Punime strukturore speciale”.

Kjo kategori licence i referohet punimeve të parashikuara në preventiv,

SipasVKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, kategoria **NS-18A** “Punime Topogjeodezike”.

Kjo kategori licence i referohet punimeve të parashikuara në preventiv,

Në përcaktimet e pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet që “**Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit**, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”

Operatori Ekonomik duhet të paraqese **certifikatat e cilësisë së punimeve, per objektin qe prokurohet, sipas standardeve:**

- **Certifikate ISO 9001 - 2015** “Per Sistemin e menaxhimit te cilesise”, objekti i se ciles te jete ne perputhje me objektin e prokurimit.
- **Certifikate ISO 14001-2015** “Per sistemin e menaxhimit te mjedisit”, objekti i se ciles te jete ne perputhje me objektin e prokurimit.

-
- **Certifikate ISO 45001-2018**“Per sistemin e menaxhimit te shendetit dhe sigurimit ne pune”, objekti i se ciles te jete ne perputhje me objektin e prokurimit.
 - **Certifikate EN - ISO 3834-2 : 2006** “Per sistemin e menaxhimit te cilesise ne saldim” ose ekuivalente me te, objekti i se ciles te jete ne perputhje me objektin e prokurimit.
 - **Certifikate 50001 : 2018**“Per Sistemin e menaxhimit te energjise”objekti i se ciles te jete ne perputhje me objektin e prokurimit.
 - Nese certifikatat jane ne gjuhe te huaj, ato te paraqiten te perkthyer dhe te noterizuara ne gjuhen zyrtare shqipe. Keto certifikata te jene leshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit i akredituar nga Drejtoria e Pergjithshme e Akreditimit ose nga organizmat nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise. Certifikatat duhet te jene te vlefshme ne kohen e zhvillimit te tenderit. Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili operator ekonomik duhet te dorezoje certifikatat e mesiperme sipas natyres se punimeve qe do te marre persiper te realizoje, referuar kontrates se bashkepunimit te nenshkruar.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, *”Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.”* dhe pika 1 , neni 44, të VKMnr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.*Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, I akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.*

Për vete natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët të kryejnë shërbimet dhe realizojnë objektin e kontratës me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësië dhe të mjedisit janë standarde që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përse kohë do të pranohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit pergjegjes për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës.

Kriteri i mesiperme per paraqitjen e certifikatave ISO është nëpërpjesëtimmenatyrën dhe përmasate kontratës që dotë prokurohet dhe jodiskriminuese për operatorët.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë stafin kryesor e mbështetës, punonjësit specialistë dhe çertifikimet përkatëse, si më poshtë:

a) Operatori Ekonomik duhet të ketë punësuar mesatarisht të **paktën 60 punonjes** për periudhë 3 (tre) muajve të fundit duke marrë si referencë datën e hapjes së tenderit.

Eshtë e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas shtojcës Nr.8. Ndërsa Operatori Ekonomik fitues, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, duhet të dorëzojë dokumentacionin:

- Vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën e mesiperme.
- Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, të paraqitura dhe të konfirmuara nepermjet formes elektronike nga organet tatimore për periudhën e mesiperme.

b) Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, **Drejtuesit Teknik** si më poshtë:

- Inxhinier Topograf/Makshajder 1 (nje)
- Inxhinier Ndertimi 1 (nje)

Drejtuesit Teknik të jenë të përfshirë në liçencën e shoqërisë, të figurojnë në listëpagesa për të paktën 3 (tre) muajt e fundit, të kene kontrate pune të vlefshme, të deklarojnë se nuk janë të angazhuar në kontrata të tjera dhe se do të jenë të pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt.

Operatori Ekonomik përmbushjen e këtij kriteri duhet ta përcaktojë me anë të një deklaratë nga administratori i shoqërisë për personelin kryesor, Drejtuesit Teknik të punimeve në objekt.

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë vërtetësinë e deklaratës. Në rast deklarimi të rreme do të veprohet në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

Eshtë e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas Shtojcës Nr.8. Ndërsa Operatori Ekonomik fitues, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, për Drejtuesit Teknik duhet të dorëzojë dokumentacionin:

- Kontratë pune e vlefshme gjatë gjithë kohës së zbatimit të punimeve objekt kontrate;
- Diplomë profesionale;
- CV
- Libreze pune

-
- Kartela personale të sigurimit teknik të vlefshme të lëshuara nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për certifikimin e punonjësve sipas parashikimeve të Ligjit Nr.8734 datë 01.02.2001 dhe Ligjit Nr. 13/2013.

c) Operatori Ekonomik për të realizuar objektin e prokurimit, duhet të ketë në stafin e tij (staf mbështetës):

- 1(nje) Inxhinier Ndertimi
- 1(nje) Inxhinier Hidroteknik
- 1(nje) Inxhinier Mjedisi
- 1(nje) Inxhinier Gjeolog
- 1(nje) Inxhinier Elektrik
- 1(nje) Inxhinier Mekanik

Shenim: Inxhinieri i Ndertimit të jete i pajisur me certifikate për testimin e performancës së produkteve të ndertimit modul- standart për sigurinë e cilësisë së produkteve të ndertimit.

Eshtë e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas Shtojcës Nr.8. Ndërsa Operatori Ekonomik fitues, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, për stafin e inxhinierëve të sipercituar, duhet të dorëzojë dokumentacionin:

- Kontratë pune e vlefshme gjatë gjithë kohës së zbatimit të punimeve objekt kontrate;
 - Diplomë profesionale;
 - Libreze pune.
 - Kartela personale të sigurimit teknik të vlefshme të lëshuara nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për certifikimin e punonjësve sipas parashikimeve të Ligjit Nr.8734 datë 01.02.2001 dhe Ligjit Nr. 13/2013.
- d. Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar stafin teknik të përbërë nga të paktën **30 punonjës** të specializuar dhe të certifikuar sipas profesionit që kryejnë dhe të pasqyruar në listë pagesat e shoqërisë për periudhën 3 muajt e fundit, me profesione si më poshtë:
- **2 (dy) Teknike Hidraulike**, shoqëruar me kontratë pune të vlefshme dhe diplomë profesionale / dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas Ligjit Nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”.
 - **2 (dy) Muratore**, shoqëruar me kontratë pune të vlefshme dhe diplomë profesionale / dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit Nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”.

-
- **1 (nje) Teknik ndertimi**, shoqëruar me kontratë pune të vlefshme dhe diplomë profesionale/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit Nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”
 - **1(nje) specialist elektrikist**, me kontratë pune të vlefshme dhe diplomë profesionale/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit Nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”.
 - **2 (dy)specialiste karpentiers** shoqëruar me kontratë pune të vlefshme dhe diplomë profesionale/dëshmi që vërteton nivelin ekualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit Nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”.
 - **1 (nje) specialist hidroizolues** shoqëruar me kontratë pune të vlefshme dhe diplomë profesionale/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike / private të licencuara sipas ligjit Nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”
 - **2 (dy) mekanike**, shoqëruar me kontratë pune të vlefshme dhe diplomë profesionale/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit Nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”.
 - **2 (dy) nivelues betoni**, shoqëruar me kontratë pune të vlefshme dhe diplomë profesionale/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit Nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”.
 - **2 (dy) Suvatues**, shoqëruar me kontratë pune të vlefshme dhe diplomë profesionale/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit Nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”.
 - **2 (dy) saldatore**, te specializuar dhe certifikuar per saldimin e tubave dhe pjeseve me elektrofuzion, si dhe per instalime te materialeve polietilen (PE) shoqëruar me kontratë pune të vlefshme, **license / certifikim si saldatore** dhe diplomë profesionale / dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas Ligjit Nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”;
 - **1 (nje) hekurkthyes** shoqëruar me kontratë pune të vlefshme dhe diplomë profesionale/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit Nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”
 - **2(dy) pllakashtrues** shoqëruar me kontratë pune të vlefshme dhe diplomë profesionale/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit Nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”

-
- **1 (nje) bojaxhi** shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme.
 - **6 (gjashte) shofere** për drejtimin e mjeteve kamiona, shoqëruar me kontratë pune të vlefshme dhe leje drejtimi me kategorine "C" dhe/ose "CE" dhe/ose "D" dhe/ose "DE" leshuar nga Drejtoria e Pergjithshme e Sherbimit të Transportit Rrugor.
 - **Eshtë e mjaftueshme paraqitja e deklaratës sipas Shtojcës Nr.8. Ndërsa Operatori Ekonomik fitues, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" të ndryshuar, duhet të dorëzojë dokumentacionin si më poshtë:**
 - Kontratë pune të vlefshme gjatë gjithë kohës së zbatimit të punimeve objekt kontrate.
 - Diplomë profesionale / dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, leshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit Nr.15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë";
 - Per specialistet e mesiperm (*me përjashtim të punonjësve bojaxhi dhe shofere*) të paraqiten Kartela personale të sigurimit teknik të vlefshme të leshuara nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për çertifikimin e punonjësve sipas parashikimeve të Ligjit Nr.8734 datë 01.02.2001 dhe Ligjit Nr. 13/2013.

e) Operatori Ekonomik duhet të ketë të pakten :

- **4 (kater) Manovratore / Eskavatoriste**

Te cilët mund të jenë pjesë e stafit ose të kontraktuar me kontratë pune/shërbimi, për realizimin e objektit të prokurimit me afat deri në përfundimin e kontratës.

Eshtë e mjaftueshme paraqitja e deklaratës sipas Shtojcës Nr.8. Ndërsa Operatori Ekonomik fitues, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" të ndryshuar, duhet të dorëzojë dokumentacionin:

- Dëshmi e aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda të ndërtimit dhe punimeve në tokë (të vlefshme) leshuar nga Drejtoria e Pergjithshme e Sherbimit të Transportit Rrugor;
- Kontratë pune / shërbimi të vlefshme;
- Kartele personale të sigurimit teknik të vlefshme të leshuara nga institucione shtetërore ose nga subjekte juridike private të akredituara për çertifikimin e punonjësve.

f) Operatori Ekonomik duhet të ketë të pakten :

- **1 (një) punonjës të certifikuar** me dëshmi trajnimi si "Specialist për sigurimin teknik dhe shëndetin në punë" të leshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të akredituara nga DPA ose nga organizmat

nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise, kerkese kjo ne perputhje me kerkemat e Ligjit Nr.10327 date 18/02/2010 "Per sigurine dhe shendetin ne pune" dhe V.K.M Nr. 312 date 05.05.2010 "Per miratimin e rregullores per sigurine ne kantier". Në rastin e bashkimit të Operatorëve Ekonomikë, secili prej operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1(një) "Specialist per sigurimin teknik dhe shendetin ne pune".

- g) Operatori Ekonomik duhet te kete te punesuar mjekun e shoqerise ose mjek te kontraktuar nga jashte me kontrate sherbimi / me subjekte te specializuara per kete qellim. Mjeket te jene te pajisur me licencë profesionale nga Ministria e Shëndetësisë. **Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej anëtarëve të bashkimit qe ploteson kriteret e VKM Nr.742 date 06.11.2013, duhet te plotesoje kete kerkese.**

Argumentimi: AK argumenton se kërkesa për *Përgjegjësin për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë* është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”, si dhe në mbështetje të Nenit 7 të Ligjit Nr. 10237, datë 18.02.2010, “*Për sigurinë dhe shëndetin në punë*“, sipas të cilit: „*Punëdhënësi ngarkon një ose disa punëmarës që të merren me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë.....*“.

Theksojmë se, Autoriteti Kontraktor ka qëllim realizimin e kontratës objekt prokurimi sipas kushteve të përcaktuara në DST, duke respektuar çdo rregull lidhur me kantierin e ndërtimit si dhe me sigurinë e punonjësve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së punës. Është e rëndësishme që punimet të realizohen brenda një kantieri të sigurt duke mbrojtur jetën e punonjësve, por dhe të kalimtarëve që mund të jenë përreth vendit të punimeve. Për sa më lart, punonjësi i cili është i çertifikuar si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë", nëpërmjet dijes dhe eksperiencës të fituar në këtë fushë, duhet të shmangë apo parandalojë çdo rrezik që mund të shfaqet gjatë veprimtarisë së shoqërisë dhe që mund të çënojë shëndetin apo sigurinë në punë. Në këto kushte, vendosja e këtij kriteri shërben si një garanci që Ofertuesit do të reazlizojnë punimet sipas standarteve ligjore në fuqi.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK..

Në përcaktimet e pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet që “*Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin*”

Nuk do te njihen si deshmi profesionale kurset e trajnimit të lëshuara nga subjekte të cilat nuk janë të licensuara/akredituara nga institucionet përkatëse për licensimin/akreditimin e tyre.

Argumentimi: Kërkesat e shkronjave a) dhe b), të pikës 2.3.3, të kriterëve të veçanta për kualifikim, janë bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar dhe VKM nr. 514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)”, të rishikuar dhe me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.

- **Inxhinieri i Ndërtimit** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore, referuar preventivit I (Punime Prishje), II (Punime b/a dhe hekuri), IV (Ndërtim mure dhe tavane me gips dhe bojatisje).
- **Inxhinieri Hidroteknik** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore, referuar preventivit të ”Instalimeve H/S”, ”Instalimet e shkarkimeve te ujrave te shiut” etj..
- **Inxhinieri Elektrik** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore, referuar preventivit të instalimeve elektrike. Seksioni XII (Instalime elektrike, internet dhe kamera).
- **Inxhinieri Mekanik** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore, referuar preventivit të konstruksioneve metalike dhe sistemit antizjarr. **Seksioni VI (Konstruksione metalike)**, Seksioni IX (Instalime per sistemin e mbrojtjes kundra zjarrit).
- **Inxhinieri Topograf** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore, referuar preventivit per sistemimet e jashtme. Seksioni XIII (Punime per sistemimet e jashtme).
- **Tekniku i ndërtimit** është i nevojshem për ndjekjen e realizimit të punimeve të ndërtimit, sipas zërave të preventivit të punimeve, si nje ”urë lidhëse” ndërmjet inxhinierit/reve dhe punonjësve, në mënyrë që ketyre të fundit, tu shpjegohet në mënyrë sa më të kuptueshme projekti dhe detajet teknike të tij.
- **Inxhinjer Mjedisi** Referuar preventivit te Punimeve perkatesisht kapitullit XIII.Punime te sistemimit te jashtem, ku perfshihen zera punimesh qe kane ndikim ne mjedis dhe eshte e nevojshme prezenca e **Inxhinierit te Mjedisit**.
- **Tekniku elektricist** është i nevojshem për ndjekjen e realizimit të punimeve elektrike në objekt, sipas zërave të preventivit të punimeve, si nje ”urë lidhëse” ndërmjet inxhinierit/reve dhe punonjësve, në mënyrë që ketyre të fundit, tu shpjegohet në mënyrë sa më të kuptueshme projekti dhe detajet teknike të tij.
- **Tekniku ing.mekanik** është i nevojshem për ndjekjen e realizimit të punimeve me natyre mekanike si pompa e zjarrit, sipas zërave të preventivit të punimeve, si nje ”urë lidhëse” ndërmjet inxhinierit/reve dhe punonjësve, në mënyrë që ketyre të fundit, tu shpjegohet në mënyrë sa më të kuptueshme projekti dhe detajet teknike të tij.

- **Hidrauliku** është i nevojshem për ndjekjen dhe realizimin e punimeve hidraulike, sipas zërave të preventivit të punimeve.
- **Elektriçisti** është i nevojshem për ndjekjen dhe realizimin e punimeve elektrike, sipas zërave të preventivit të punimeve.
- **Hekurkthyesi** është i nevojshem për përzgjedhjen, prerjen, kthimin dhe vendosjen e hekurit, sipas zërave të preventivit të punimeve.
- **Saldatori** është i nevojshëm për saldimin, drejtimin, bashkimin e detaleve të ndryshëm, me prerjen e tyre, me bashkimin e objekteve të madhësive dhe formave të ndryshme duke përdorur mjetet dhe pajisjet e duhura, sipas zërave të preventivit.
- **Karpentieri** është i nevojshëm për prerjen dhe montimin e strukturave prej druri si dhe ndërtimin e kornizave dhe strukturave të tjera përforcuese prej druri apo materiale të tjera, të nevojshme për realizimin e objektit që do të ndërtohet.
- **Bojaxhiu** është i nevojshëm për realizimin e punimeve të lyerjes sipas zërave të preventivit.
- **Shtrues pllakash** është i nevojshëm për realizimin e shtrimit dhe veshje me pllaka të godinës objekt rikonstruksion, sipas preventivit.
- **Murator** është i nevojshëm për realizimin e mureve të tullës të godinës objekt rikonstruksion, sipas preventivit.

Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të paktën një drejtues teknik të shoqërisë ose një person që të disponojë dëshmi trajnimi si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë” në përputhje me klauzolat e ligjit nr. 10237 date 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe VKM nr. 312 date 05.05.2010 “për miratimin e rregullores”, “Për sigurinë në kantier”. Për drejtuesin teknik të shoqërisë duhet të paraqitet certifikata e trajnimit për “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”, e dhënë nga një organizim i licensuar, shqiptar ose i huaj si dhe kontrata e punës.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësisht dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: Kërkesa e shkronjave c), të pikës 2.3.4, të kriterëve të veçanta për kualifikim, është bazuar në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 10237 date 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe VKM nr. 312 date 05.05.2010 “për miratimin e rregullores”.

h) Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar mjekun e shoqërisë ose mjek të kontraktuar nga jashtë me kontratë shërbimi / me subjekte të specializuara për këtë qëllim.

Mjeket të jenë të pajisur me licencë profesionale nga Ministria e Shëndetësisë. **Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej anëtarëve të bashkimit që plotëson kriteret e VKM Nr.742 date 06.11.2013, duhet të plotësojë këtë kërkesë.**

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: Kërkesa e kriterëve të veçanta për kualifikim, është bazuar në përputhje me parashikimet e VKM nr. 108, datë 9.2.2011 “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë” i ndryshuar, sipas të cilave, kompanitë që operojnë në fushën e ndërtimit, mund të sigurojnë shërbimet mjekesore për stafin e tyre, nepermjet punesimit të një mjeku, apo nëpërmjet marrëdhënieve kontraktore me individë apo subjekte që operojnë në këtë fushë.

a) Operatori Ekonomik duhet të ketë punësuar mesatarisht të **paktën 60 punonjes** përperiudhën e 3 (tre) muajve të fundit duke marrë si reference datën e hapjes së tenderit.

Është e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas shtojcës Nr.8. Ndërsa Operatori Ekonomik fitues, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, duhet të dorëzojë dokumentacionin:

- Vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën e mesiperme.
- Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, të paraqitura dhe të konfirmuara nepermjet formës elektronike nga organet tatimore për periudhën e mesiperme.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe referuar grafikut të punimeve të hartuar nga specialist të fushës. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore si dhe përvojën e nevojshme për ekzekutimin e kontratës objekt prokurimit.

Referuar grafikut të punimeve të hartuar nga grupi i punës i ngritur pranë autoritetit kontraktor për këtë procedurë prokurimi.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore si dhe përvojën e nevojshme për ekzekutimin e kontratës objekt prokurimi, duke pasur parasysh edhe grafikun e punimeve.

Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës :

1.	Kamiona mbi 18 ton	2 (dy) cope
2.	Kamiona nga 7.5deri 18 ton	2 (dy) cope
3.	Kamiona nga 5 deri 7 ton	2 (dy) cope
4.	Kamioncina	2 (dy) cope
5.	Autovinc	2 (dy) cope
6.	Rimorkiator per transportin e makinerive	1 (nje) cope
7.	Eskavator me goma ose/dhe zinxhire per copetim shkembi 1,0 m3	1(nje) cope
8.	Minieskavator	2 (dy) cope
9.	Betoforma (armature per betonime)	300 m2
10.	Skele metalike	450 m2
11.	Bitumatriçe	1 (nje) cope
12.	Asfaltshtruese	1 (nje) cope
13.	Rrul me vibrim ose kompresor	1 (nje) cope
14.	Autobetoniere	1 (nje) cope
15.	Betoniere te vogla0.5 m3	3 (tre) cope
16.	Autopompe betoni	1 (nje) cope
17.	Vibrator betoni	2 (nje) cope
18.	Makineri Prerese Betoni	1 (nje) cope
19.	Autobot uji	1 (nje) cope
20.	Matrapik	1 (nje) cope
21.	Aparat hekurkthyes	1 (nje) cope
22.	Saldatrice	1 (nje) cope
23.	Gjenerator	1 (nje) cope
24.	Gazogjen	1 (nje) cope
25.	Pompe Suvatimi	1 (nje) cope
26.	Trapan elektrik	1 (nje) cope
27.	Nyje per inerte; (ne pronesi/me qera/kontrate furnizimi)	1 (nje) cope
28.	Fabrike Asfaltobetoni (ne pronesi/me qera/kontrate furnizimi)	1 (nje) cope

Mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit në zbatim të kërkesave të VKM Nr. 312 datë 05.05.2010 "Per miratimin e Rregullores per sigurine ne kantier", si më poshtë vijon:

-
- Kokore + Jeleke fosforoshente minimumi 30 cope.
 - Fikëse zjarri të lëvizshme minimumi 2 copë
 - Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 4 copë
 - Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi 4 copë
 - Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 6 copë

Per mjetet qe shenohen ne rregjistra publike duhet te paraqitet dokument qe verteton pronesine e mjetit (certifikate pronesie), dokument qe verteton rregjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), certifikata e kontrollit teknik SGS si dhe siguracionin e mjetit (police sigurimi); te vlefshme. Per mjetet e siguruara me qera, te paraqiten dokumentet qe vertetojne rregjistrimin e tij, plus certifikaten e kontrollit teknik (SGS) dhe siguracionin e mjetit te vlefshme. Keto dokumente duhet te shoqerohen me kontraten perkatese te qerese te vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi. Per mjetet e tjera qe nuk jane te shenuara ne rregjistra publike duhet te paraqitet kontrate noteriale e blerjes / fature tatimore / dokument zhdoganimi te mjetit.

Per pajisjet ne pronesi shoqerohen me akt pronesie origjinal ose fotokopje te noterizuar (kontrata shit- blerje, kontrata dhurimi, fatura tatimore shitje,deklarate zhdoganimi) te vlefshme.

Per pajisjet me qera te paraqitet kontrata e lidhur para noterit per kete objekt shoqeruar me akt pronesie origjinal ose fotokopje te noterizuar(kontrata shit-blerje, kontrata dhurimi, fatura tatimore shitje, deklarate zhdoganimi) te vlefshme.

Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve të targuara duhet të jetë e dukshme ne nje foto te vetme mjete dhe targa e tij.

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me anë të së cilës të deklarojë vendndodhjen e mjeteve të kërkuara në procedurën e prokurimit publik si dhe te pranoje verifikimin e mjeteve dhe pajisjeve të deklaruar në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës nga Autoriteti Kontraktor.

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës deklaronte se mjetet dhe pajisjet e deklaruar nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Në përcaktimet e pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet që **“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të**

ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Numri i fuqisë punëtore i kërkuar (minimumi 60 persona), mjetet dhe pajisjet e kërkuara janë vendosur në proporcion me zërat dhe volumet e punimeve dhe afatin e përllogaritur për realizimin e kontratës objekt prokurimi. Në DT janë listuar vetëm punonjësit e kualifikuar të nevojshëm për realizimin e punimeve. Në numrin total prej 60 punonjësish që janë kërkuar në DT janë të përfshirë edhe punonjësit e thjeshtë të cilët nuk kërkojnë një kualifikim profesional të posaçëm. Përllogaritja e numrit total prej 60 punonjësish është bërë referuar manualit të çmimeve të VKM nr. 629, datë 15.09.2015 dhe volumeve të punimeve të parashikuara në preventive dhe kohës së nevojshme për realizimin e punimeve sipas grafikut të punimeve. Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve në pronesi / qira janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke i’u referuar punimeve sipas standardeve, orëve të punës, grafikut, kohëzgjatjes së punimeve dhe specifikimeve teknike të projekteve. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomik duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisje dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës.

Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e

mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

NJESIA E PROKURIMIT